

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Debati i pagave të magjistratëve, Analisti: Kërkesa e gjyqtarëve e tepruar, reforma në drejtësi duhet riparë                                                                                                                                          |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/politika/debati-i-pagave-te-magjistrateve-analisti-kerkesa-e-gjyqtareve-e-teprua-i586018">https://www.gazetatema.net/politika/debati-i-pagave-te-magjistrateve-analisti-kerkesa-e-gjyqtareve-e-teprua-i586018</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | redirected                                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 14 shtator 2026, 12:16:51 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 12:50:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | daac175b0ce15d9347f908c2bd6e31d7d2eea9404302116c0ab42303d3e3834f |
| TEKSTI     | 2989b7fda7d88f5f6fc8666269565e6bc2a260a3e6fb9b22a336ba1a56d9b16a |
| PAMJA      | 5881eefa264fbafb74ef933a6d4b65c43f25235cde749799a2ac614569218b7c |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 775bab8dfbc41b52a61b9dab4939d4f5bcaa2dab31363566111a8bad1925dc3f                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/775bab8dfbc41b52a61b9dab4939d4f5bcaa2dab31363566111a8bad1925dc3f>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Futurimet gjate veres: Shqiperia mes vendeve me rritje te larte te trankut ajror VIDEO/ Kriza e pagave ne drejtësi. Braçe: KLGJ dhe KLP duhet t'u kerkojne ndjese deputetë fundit

## Debati i pagave të magistratëve, Analisti: Kërkesa e gjyqtarëve e tepruar, reforma në drejtësi duhet riparë



14 Shtator 2026, 14:50Politika TEMA



Kuvendi i Shqipërisë nis shqyrtimin e projektligjit për pagat e gjyqtarëve, pas diskutimit duke nisur nga sot në komisionin parlamentar të ekonomisë.

Maxhoranca thotë se pagat e magistratëve do të rriten vetëm me ligj nga Kuvendi, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa ka refuzuar presionin e tyre ndaj qeverisë për të paguar pagat e rritura nga ata vetë.

Kryeministri i vendit, Edi Rama thotë se gjyqtarët shqiptarë janë më të paguarit në Rajon.

Analisti Artur Nura, i ftuar në **"News Line"** u shpreh se kjo çështje duket rregulluar me ligj. Ai theksoi se në këtë pikë, Politika ka kusuret e veta, sepse i ka dhënë pushteti gjyqësor pushtet të jashtëzakonshëm.

"Një gjyqtar sot merr afërisht sa presidenti i Republikës. Nuk mund t'i japësh sistemit të drejtësisë sistemin politik, sepse pastaj kemi një çarje të balancave. Shumica qeverisëse ka të drejtë, që këtë vullnet ta konsultojë në departamentet përkatëse dhe ta hedhë pastaj për miratim. I kanë dhënë pushtet të jashtëzakonshëm gjyqësorit dhe politika e ka të vështirë të bëjë balancën", theksoi ai.

Ai pohoi se pjesa që kërkojnë gjyqtarët është e tepruar dhe e ekzagjeruar. Sipas tij, kjo përplasje e krijuar mes ekzekutivit dhe gjyqësorit ka nxjerrë në pah nevojën e domosdoshëm që reforma në drejtësi duhet të rishikohet.

"Gjyqtarët nuk e kanë problemin për të mbyllur muajin, siç mund ta kenë disa qytetarë. Politika i ka dhënë pushtet të jashtëzakonshëm pushtetit të drejtësisë. Ajo çfarë kërkojnë gjyqtarët është e tepruar.

Në jemi republikë parlamentare dhe kështu duhet të mbetemi. Parlamenti është organi më i lartë, formalisht është vetëm presidenti. Reforma në drejtësi duhet riparë, për të harxhuar para më pak dhe për të pasur drejtësi më shumë. Duhet rregulluar me ligj kjo pjesë.", tha ai.



Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Kriza e pagave në drejtësi, Braçe: KLGJ dhe KLP duhet t'u kërkojnë ndjesë deputetëve, morën kompetencat e Kuvendit](#)

14:07 Politika

[Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së \(VIDEO\)](#)


13:38 Politika / 2 komente

[Pagat e magjistratëve, Rama reagon sërish: Historia e botës s'e ka parë që gjykatësit të thonë do t'i marrim paratë vetë nga thesari i shtetit se janë tonat!](#)

13:29 Politika / 3 komente

[Kryetarët e bashkive të Rrjetit B40 deklarë të përbashkët për mbajtjen në paraburgim të Veliajt: Po goditet demokracia vendore](#)

13:00 Politika / 3 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.